



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:271705  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05631408

**C-IV-14-2749**  
*Parashtruesi i kërkesës*

**F F**, fshati S, Podujevë, përfaqësuar nga avokati **B I**, Prishtinë

*kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH FAN “Zahir Pajaziti” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 29 prill 2024 lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1. Kërkesa për rishikimin e Aktvendimeve të Autoritetit të Likuidimit aprovet si e bazuar.**
- 2. SHFUQIZOHEN Aktvendimet e Autoritetit të likuidimit PRN046-0234 datë 26 mars 2014, PRN046-0235 datë 26 mars 2014 dhe PRN046-0236 datë 26 mars 2014.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, F F, në emër të kompensimit të tri pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 1,048.20 Euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8 % t'i paguhet shuma prej 83.85 Euro.**
- 4. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, F F, në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, ti paguhet shuma prej 2,096.40 Euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8 % t'i paguhet shuma prej 167.71 Euro.**
- 5. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, F F, në emër të kompensimit të pagave për periudhën prej muajit dhjetor 2002 gjer mars 2003, janar gjer mars 2004 si dhe dhjetor 200, ti paguhet shuma prej 1,600.00 Euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8 % t'i paguhet shuma prej 128.00 Euro.**
- 6. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, F F, ti kompensoj pagesën e taksave gjyqësore në shumë prej 20.00 Euro.**
- 7. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që përfaqësuesit të ankuesit, avokat B I në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës të ja paguaj shpenzimet e**

**procedurës në shumë prej 208.00 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur prej 104.00 Euro në emër të kërkesës kreditore dhe shqyrtimit të shkresave refuzohet.**

## **8. Nuk caktohen shpenzime tjera.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Fillimisht, pranë DHPGJS me 14 prill 2014, është parashtruar një pliko (zarf) në të cilën janë bashkangjitur, Vendimet e Autoritetit të Likuidimit ( AL), si në vijim:

- PRN046-0234 datë 26 mars 2014 ( në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri (3) pagave të papaguara, për periudhën janar 2006 - mars 2006 në shumë prej 1,048.20 (një zero katër tetë dy zero) Euro,
- PRN046-0235 datë 26 mars 2014 ( në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë të paspecifikuar, dhe
- PRN046-0236 datë 26 mars 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 1,600.00 (një gashtë zero zero) Euro, për periudhën prej muajit dhjetor 2002 gjer mars 2003, janar gjer mars 2004 si dhe dhjetor 2004, kërkesa këto ndaj NSH “Zahir Pajaziti” (në likuidim).

Gjithashtu i janë bashkangjitur:

- Kopja e librezës së punës,
- Kopja e një liste të pagave, për ankuesin, për muajin dhjetor 2002 gjer mars 2003, janar gjer mars 2004 dhe dhjetor 2004 gjer mars 2005 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 1),
- Kopja e Njoftimit, lëshuar nga Agjencia, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit, datë 24 mars 2006 ( në tekstin në vijim NJOFTIMI),

Me 9 dhjetor 2021, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin, me të cilin u njoftua respektivisht u kërkua që lidhur me rastin duhet të parashtrorj kërkesë për rishqyrtim-ankesë, në formë të shkruar.

Duke vepruar sipas urdhrorit, të cekur si më lartë, me 28 dhjetor 2021, përfaqësuesi i ankuesit parashtrorj kopjen e kërkesës për rishqyrtim- të emërtuar ankesë, me të cilin e atakon Vendimet e AL, të cekura si më lartë.

Ankuesi pohon se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me anë të njoftimit të Agjencisë dhe se me të njëjtin njoftim janë njoftuar mbi të drejtat e punëtorit lidhur me pagat e mbetura borxh. Duke vepruar sipas këtij njoftimi dhe njoftimit mbi likuidimin e NSH, ankuesi, ka vepruar dhe ka dorëzuar kërkesat e tij mbi pagat, si ato mbi pagat e papaguara ashtu edhe mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Ankuesi fillimisht pretendon, se në bazë të Ligjit të punës ankuesit i takon e drejta në kompensim, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në 6 (gjashtë) paga, duke e llogaritur pagën mujore prej 349.40 Euro e që në total i bie që i takon shuma prej 2,096.40 (dy zero nëntë gjashtë katër zero) euro.

Me kërkesën për rishikim, kontestohen Vendimet i AL lidhur me parashkrimin mbi faktin se dispozita e Ligjit për punën e bashkuar –LPB (neni 608) nuk mund të aplikohet dhe duhet të konsiderohet jo – relevante sipas praktikës së DHPGJS si dhe LPB në tërësi konsiderohet si ligj

jo i aplikueshëm, sipas Ligjit mbi ndërmarrjet – LN nr. 77/88 (gazeta zyrtare e RSFJ). Lidhur me këtë, ankuesi i referohet Vendimeve të DHPGJS.

Ankuesi në vijim pohon, se AL me Vendimin e saj, ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP, Ligjit të Punës, nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut – KELDNJ.

Ankuesi gjithashtu kërkon kamatë ligjore, në lartësi prej 8%, dhe kërkesën e mbështet sipas dispozitave ligjore të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve – LMD.

Nga gjitha arsyet ankuesi kërkon, nga gjykata, që Vendime e AL të prishen dhe kërkesat e tij, në shumë prej ,600.00 (një gashë zero zero) Euro, 1,048.20 (një zero katër tetë dy zero) Euro dhe në shumë prej 2,096.40 (dy zero nëntë gjashtë katër zero) Euro për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, duke përfshirë edhe kamatën ligjore në lartësi prej 8% të shumës, të aprovohen.

Përfaqësuesi i ankuesit kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, në shumë të përgjithshme prej 508.00 Euro dhe atë lidhur me kërkesën drejtuar AL në shumë prej 78.00 Euro, shqyrtimit të shkresave në shumë prej 78.00 Euro, hartimit të kërkesës për rishikim-ankesës në shumë prej 176.00 Euro dhe përgjigjes në përgjigjen e AKP shumën prej 176.00 Euro.

U kërkua edhe kompensimi i taksave gjyqësore në shumë prej 20.00 (dy zero) Euro.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e NJOFTIMIT,
- Kopja e shkresës së AKP drejtuar ankuesit, datë 21 shtator 2013,
- Kopja e një liste të pagave, për ankuesin, për muajin dhjetor 2002 gjer mars 2003, janar gjer mars 2004 dhe dhjetor 2004 gjer mars 2005,
- Kopja e listës përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë gëzuar të drejtën në 20% nga privatizimi i NSH. Në këtë listë figuron emri i ankuesit me përvojën e tij të punës prej 20 vite e 8 ditë ( në vijim LISTA E PUNËTORËVE),
- Kopja e librezës së punës,
- Kopjes së listës së pagave të punëtorëve të NSH, e përpiluar nga ana e Menaxhmentit të NSH ky gjykata gjeti si në vijim: Sipas kësaj liste, sipas së cilës emri i ankuesit figuron sipas numrit rendor 85 (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 2).

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 30 janar 2021 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankuesit ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankuesit konsiderohet e parashkruar pasi që, sipas AKP, ankuesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim ligjor në afat prej tre (3) vitesh për realizimin e kërkesës së tij. Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankuesit të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur

- Vendimi i AL PRN046-0234 datë 26 mars 2014.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesi përmes përfaqësuesit të tij me 22 shkurt 2022 parashtroj përgjigjen.

Ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim. U kërkuan shpenzimet e përfaqësuesit të ankuesit në shumë totale prej 312.00 Euro, dhe atë në emër të kërkesës drejtuar AL në shumë prej 52.00 Euro, shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumë prej 52.00 Euro, hartimin e kërkesës për rishqyrtim-ankesës në shumë prej 104.00 Euro dhe kundërshtimin e përgjigjes së AKP në shumë prej 104.00 Euro.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e autorizimit për përfaqësuesin.

Sipas urdhrit të gjykatës, AKP me 4 mars 2022 parashtroj kundërpërgjigje.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

### **Arsyetimi ligjor:**

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata konsideron se lidhur kompensimin, parashihet se si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person dhe paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbusha e kërkesave siç janë: *“kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar, duke u kufizuar në tri paga bruto por edhe përshirë edhe kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë,
- b. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe
- c. Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesi ka ofruar arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e

privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

Libreza e punës, LISTA E PUNËTORËVE , LISTA E PAGAVE 1 dhe LISTA E PAGAVE 2 si dhe NJOFTIMI të parashtruara nga ankuesi, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit, respektivisht 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja.

AKP, asnjëherë, nuk i ka kundërshtuar shumat e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohej e drejta në kompensimin. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Kërkesa për 3 (tre) paga- sipas vendimit PRN046-0234 datë 26 mars 2014

Gjykata me rastin e kërkesës për 3 (tre) paga dhe aprovimit të shumës, prej 1,048.20 ( një zero katër dy zero ) Euro, është bazuar në LISTËN E PAGAVE 2 nga e cila shihen pagat e mbetura të papaguara, të NSH, ndaj ankuesit në shumën e aprovuar.

Andaj vendosi si në pikën 3 të dispozitiv të aktgjykimit.

Kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës – sipas vendimit PRN046-0235 datë 26 mars 2014

Nga LISTA E PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, shihet se marrëdhënia e punës, së ankuesit, pranë NSH ishte për 20 vite e 8 ditë.

Gjykata gjeti se në përputhje me Ligjin e Punës (Ligji nr. 03/L-212), ligj ky në fuqi nga data 15 dhjetor 2010, nenit 76 paragrafi 7 pika 7.3, në kuptim të kompensimit i takojnë 6 (gjashtë) paga mujore. Kjo për faktin se përvoja e ankuesit, bie në kategorinë e përcaktuar, sipas dispozitës së cekur si më lartë (20 gjer 29 vite shërbimi).

Gjykata, sipas LISTËS SË PAGAVE 2, konstatoj se paga mujore e ankuesit ishte në shumë prej 349.40 (tre katër nëntë katër zero) Euro, e të cilën pagë në pajtim me dispozitën e lartë cekur e shumëzoi me gjashtë ( 6) paga mujore e që bie shuma e tërësishme prej 2,096.40 (dy zero nëntë gjashtë katër zero) Euro, (6 x 349.40 = 2,096.40), shumë kjo totale e kërkuar sipas parashtrësës së datës 21 tetor 2021.

Andaj vendosi si në pikën 4 të dispozitiv të aktgjykimit.

Kërkesa për paga në shumë prej 1,600.00 Euro, për periudhën prej muajit dhjetor 2002 gjer mars 2003, janar gjer mars 2004 si dhe dhjetor 2004 - sipas Vendimit PRN046-0236 datë 26 mars 2014.

Gjykata me rastin e kërkesës dhe aprovimit të shumës, prej 1,600.00 ( një gjashtë zero zero ) Euro, është bazuar në LISTËN E PAGAVE 1 nga e cila shihen pagat e mbetura të papaguara, të NSH, ndaj ankuesit në shumën e aprovuar.

Andaj vendosi si në pikën 5 të dispozitiv të aktgjykimit.

Andaj nga të gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1, 1.6.2 dhe 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, sipas pikës 3, 4 dhe 5 (tre, katër, pesë) të dispozitivit, veproj në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe atë në lartësinë e kërkuar prej 8%.

#### Cështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesit

Ankuesi, ka pranuar njoftimin, nga Agjencia, dhe me këtë njoftim është informuar si në vijim, citat:

- a. Si pasojë e shitjes së asetëve të NSH ky njoftim është njoftim zyrtar se punësimi juaj përfundon menjëherë (marrëdhënia e punës i ndërprerë me veprim të Agjencisë), dhe
- b. Shumat – pagat e papaguara që u janë borxh do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit (pranim i borgjit).

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB ( gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

*“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.*

Së pari, duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi parashkrimin të aplikuara dhe referuar sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në nenin 366 paragrafi 1 thuhet, citat:

*“Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi”*

Më tutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

*“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.*

Dispozitat e lartëcekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Sipas dispozitave të lartë cekura AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj ankuesit për obligime nga marrëdhënia e punës konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi.

Tutje, rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventuale, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (lex specialis).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën 4 (katër) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Shuma e mbetur prej 104.00 (një zero katë) Euro, për përfaqësim pranë AL refuzohet me arsyetim se përfaqësuesit në rastin konkret mund ti gjykohen vetëm se shpenzimet për përfaqësim pranë gjykatës e jo edhe pranë AL. Lidhur me shikimin e shkresave përfaqësuesi nuk ka bërë një veprim të tillë.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar